



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor  
dhe Infrastrukturës

Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja  
i Infrastrukture

Ministry for Environment, Spatial Planning  
and Infrastructure

# Monografi



Instituti për Planifikim Hapësinor

2003 - 2023





Republika e Kosovës  
Qeveria e Kosovës  
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

## Monografi



**Instituti për Planifikim Hapësinor**

**2003 - 2023**

Adresa:

Objekti i Qeverisë së Kosovës (Ish Rilindja)

Kati XIV, zyra 1405

[www.mmphi-rks.org](http://www.mmphi-rks.org)

<https://mmphi.rks-gov.net/Others/Department?DepartmentID=2>

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. +383 38 200 32552



## Parathënie

*Kjo broshurë del me rastin e 8 NËNTOR-it - Ditës Botërore të Planifikimit të Qyteteve, dhe shënimit të 20 vjetorit të themelimit të Institutit për Planifikim Hapësinor. Në kuadër të broshurës do të bëjmë një përmbledhje të aktiviteteve dhe arritjeve gjatë 20 viteve të shkuara, duke mos lënë anash synimet, sfidat dhe problemet për përmbushjen e qëllimit tonë madhor – mbrojtjen e vendbanimeve tona përmes zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor dhe urban.*

*Shënimi i kësaj dite të rëndësishme për sektorin e planifikimit hapësinor tashmë është bërë tradicionale, në nivelin e ditëve tjera të rëndësishme për Ministrinë tonë dhe për Kosovën në përgjithësi. Dita botërore e planifikimit të qyteteve është ditë e rëndësishme për çdo qytetar të botës, që dëshiron qytet më funksional, lagje më urbane, mjedis të mbrojtur dhe të menaxhuar me më shumë kujdes, përgjegjësi dhe pjesëmarrje më e lartë në vendime që do të merren për të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tanë. Në këtë mënyrë do të bëjmë shmangien nga praktikat e deritashme, sipas të cilave, qytetet tona janë ballafaquar me një realitet të hidhur të zhvillimeve stihike, të ngutshme, shpesh të pamenduara mirë dhe me pasoja të pakthyeshme për mjedisin.*

*Për herë të parë Dita Botërore e Planifikimit të Qyteteve është shënuar në vitin 1949, si nevojë për angazhim gjithëpërfshirës në vendosjen e politikave, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës në përgjithësi. Kjo ngjarje u iniciua nga Carlos Maria della Paolera, profesor në Universitetin e Buenos Aires, me qëllim të avancimit të interesit publik dhe profesional në fushën e planifikimit. Kjo ditë na përkujton se planerët duhet të jenë profesionistë të trajnuar, të cilët me angazhimin e tyre në institucione qeveritare, në firma konsulentë, në kompani private dhe institucione arsimore, duhet të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të mjedisit të vendbanimeve tona. Duhet të ndihmojnë në hartimin e planeve për zona të reja të zhvillimit, dhe të ndikojnë në korrigjimin e zonave të vjetra. Me angazhimin e tyre të pazëvendësueshëm të ndikojnë në hartimin e politikave qeveritare nga të cilat duhet të përfitojnë të gjithë.*

*Aktualisht, kjo ditë e rëndësishme e sektorit të planifikimit hapësinor festohet<sup>1</sup> në shumë qytete nga të gjitha anët e botës. Sa i përket organizimit, iniciuesit dhe organizatorët kryesisht janë institucione profesionale, që për qëllim kryesor kanë promovimin e planifikimit gjithëpërfshirës – duke i bërë bashkë planerët profesional dhe publikun e gjerë. Në këtë ditë të veçantë duhet të pranohet dhe promovohet roli i planerëve dhe i planifikimit, në krijimin e vendbanimeve/qyteteve në të cilat jetojmë dhe kishim pas dëshirë të jetojmë.*

*Në këtë drejtim, duke shfrytëzuar këtë ngjarje të rëndësishme, kemi zhvilluar një aktivitet të ri, që për qëllim kryesor ka promovimin e planifikimit hapësinor e urban dhe ngritjes së vetëdijes për qytetarët. Fjala është për konkursin e fotografive, të cilin do të tentojmë ta aplikojmë çdo vit në të njëjtën ditë. Temat e konkursit do të ndryshojnë nga viti në vit, dhe kryesisht do të jenë të ndërlydhura me fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, duke përfshirë edhe aspektin pozitiv edhe atë negativ të çështjes. Në përgjithësi fotografitë e mbledhura pas çdo konkursi, do të mbulojnë çështje delikate me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik për problemet e hapësirës ku ne jetojmë, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit jetësor, të drejtën qytetare për të*

<sup>1</sup> Dita botërore e planifikimit të qyteteve (WTPD) – për çdo vit promovohet nga Shoqata Ndërkombëtare e Planerëve (ISoCaRP) me seli në Hagë, Holandë.



*pasur dritë të mjaftueshme, për të pasur diell, ajër të pastër dhe të mjaftueshëm, ruajtjen e trashëgimisë, liri të lëvizjes, qasje të sigurt dhe çështje tjera me rëndësi për lagjen, vendbanimin dhe qytetin tonë.*

*Duke i marrë të gjitha parasysh, mendojmë që Instituti për Planifikim Hapësinor duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për të qenë promotor i denjë i planifikimit hapësinor e urban. Duhet të jetë promotor i planifikimit rural, i zhvillimeve racionale për një hapësirë të vogël që ka vendi i ynë, promotor i qyteteve tona mijëvjeçarë, të cilat na takojnë të gjithë neve, sepse sipas një proverbi kinez: “Qytetet nuk i kemi trashëguar nga të parët tanë – ato i kemi huazuar nga nipat tanë”.*





## INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

### **Themelimi**

*Instituti për planifikim hapësinor është i vetmi institucion shtetëror që merret me hartimin e planeve hapësinore të nivelit qendror dhe së bashku me Departamentin e Planifikimit Hapësinor përbëjnë sektorin e planifikimit hapësinor në Qeverinë e Kosovës përkatësisht Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Është themeluar në Tetor të vitit 2003 me akt të veçantë të nënshkruar nga Ministri i atëhershëm i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.*

*Në kuadër të Institutit punojnë profesionistë të fushave të ndryshme si: arkitektë, gjeografë, urbanistë dhe profile tjera. Që nga themelimi e deri në ditët e sotme, ajo që e karakterizon Institutin është puna grupore profesionale, e cila në të shumtën e rasteve rezulton me përfundimin e punëve në kohë dhe me sukses.*

### **Veprimtaria**


*Veprimtaria kryesore e këtij institucioni është hartimi i Planit Hapësinor të Kosovës dhe përgatitja dhe hartimi i planeve të zonave me përmbajtje të veçantë dhe me interes për shtetin. Veprimtari tjetër e rëndësishme është ngritja e kapaciteteve humane dhe ndihma teknike profesionale e punëtorëve të nivelit komunal, në përgatitjen dhe hartimin e planeve komunale.*

*Prej vitit 2003 e deri më sot, janë prodhuar disa dokumente të rëndësishme dhe të nevojshme për sektorin e planifikimit hapësinor në veçanti dhe në përgjithësi dokumente të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës. Të gjitha materialet dhe dokumentet e prodhuara janë të përmbledhura në formën e dokumenteve zyrtare dhe janë pjesë përbërëse e faqes sonë të internetit.*

*Gjithashtu, në bashkëpunim të ngushtë me sektorët e rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, janë hartuar një set i tërë i raporteve sektoriale, të nevojshme për paraqitjen sa më reale të zhvillimit hapësinor sektorial. Një grup i veçantë i punëtorëve të Institutit, kanë punuar në hartimin e analizave hapësinore për komunat e Suharekës, Vushtrrisë, Dragashit, Kaçanikut, Malishevës, Kamenicës dhe Obiliqit, dokumente këto që për nga përmbajtja kanë qenë ndihmë e madhe e komunave për përfundimin e Planeve Zhvillimore Komunale. Në bashkëpunim me Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Banimit dhe Ndërtimit, një punë e rëndësishme e Institutit, ka qenë hulumtimi që është bërë në fushën e vendbanimeve joformale. Për këtë qëllim, dhe në bazë të rezultateve të hulumtimit të zhvilluar në disa komuna, është nxjerrë udhëzuesi për trajtimin e këtyre vendbanimeve. Angazhim permanent i një pjese të konsiderueshme të stafit, ka qenë përfshirja në procesin e hartimit të planeve zhvillimor komunale. Rasti më i mirë i këtij bashkëpunim është Planit Zhvillimor për Komunën e Junikut. Nën koordinimin e UN-Habitat-it, si aktivitet është konsideruar risi në kuadër të bashkëpunimit me organet kompetente komunale, të cilin e kemi vazhduar dhe aplikuar edhe për komunat tjera të interesuara.*

## Funksionimi

E rekomanduar nga Instituti holandez IHS<sup>2</sup>, pjesa më e madhe e punëve në Institutin për Planifikim Hapësinor është realizuar në bazë të projekteve. Deri më tash, për të gjitha projektet fillimisht është përcaktuar ekipi punues, në krye të të cilit është emëruar koordinatori si përgjegjësi kryesor i procesit, i ndihmuar nga udhëheqësit e fushave tematike që janë identifikuar në bazë të përmbajtjes së projektit. Kjo është mënyra që është praktikuar që nga fillimi i funksionimit e deri më sot.



### ▷ Rekomandimet e IHS-it për organizimin dhe funksionimin e IPH-së

Aktualisht, duke ju referuar procesit të ndryshimeve dhe ri-formatizimit të MMPHI-së, është kërkuar që edhe organizimi i Institutit për Planifikim Hapësinor të jetë në përputhje me kërkesat aktuale. Synimi ynë i vazhdueshëm është që në një moment të përshtatshëm politik dhe ekonomik, Instituti të ngritet në nivel të Agjencisë ekzekutive, në të cilin do të mundësohej angazhimi i kuadrove të profileve që aktualisht i mungojnë Institutit.

<sup>2</sup> IHS – Instituti për Banim dhe Studimin e Zhvillimeve Urbane, Rotterdam, Holandë. I angazhuar nga UN-Habitat në procesin e themelimit të Institutit për Planifikim Hapësinor.




## Të arriturat

### Dokumentet e aprovuara në Kuvendin e Kosovës

#### Plani Hapësinor i Kosovës 2010-20120

Është dokumenti kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor i cili është hartuar në bashkëpunim me të gjitha sektorët e rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë edhe profesionist të dalluar të fushës, institucionet e ndryshme shkencore, universiteti, organizata të ndryshme joqeveritare, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të nivelit lokal dhe pa dyshim, shumë e rëndësishme ka qenë ndihma dhe përkrahja që është ofruar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.




Dokumentit i aprovuar në Qershor 2011 është versioni i plotësuar, i cili për bazë kishte dokumentin e aprovuar në parim në Kuvendin e Kosovës (Janar, 2007). Një veprim i tillë ishte i domosdoshëm, për shkak të ndryshimeve të atëherëshme politike të cilat sollën edhe ndryshime tjera hapësinore. Sa i përket përmbajtjes, zhvillimi i ofruar policentrik është garant i zhvillimit të barabartë të të gjitha rajoneve, komunave dhe zonave rurale në Kosovë. Me shumë kujdes janë shfrytëzuar potencialet e shumëta dhe karakteristike për rajonet, që paraqesin bazë të mirë për zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë vendit.

▷ Harta kryesore e dokumentit

### **Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë”**

Është dokumenti i parë hapësinor që trajton temën e luftës dhe sakrificën e popullit tonë për liri. Pa dyshim se një projekt i tillë ka qenë shumë sfidues për të gjithë ne – për Qeverinë që kanë bërë shpalljen e zonës me interes të veçantë, për Ministrinë tonë që ka qenë bartëse e procesit për hartimin e dokumentit, ashtu dhe për Institutin për Planifikim Hapësinor si hartues të dokumentit.

Hapësira për të cilën kemi hartuar planin hapësinor është e njohur padyshim për të gjithë qytetarët e Kosovës. Është e njohur për aktivitetet që janë zhvilluar gjatë luftës së fundit, për sakrificën e popullit të kësaj ane, që edhe përkundër varfërisë së tyre të madhe – kanë ofruar ndihmë dhe strehim për ushtarët e UÇK-së dhe për popullatën e shpërngulur nga trevat tjera të Kosovës. Kjo zonë ishte gjithashtu selia e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, dhe Malet e Berishës ishin vendi ku nisën rreshtimet ushtarake dhe trajnimet e para për ofensivat kundër okupatorit. U caktuan veprimet e ushtrisë më të re në botë, u organizuan paraqitjet e para publike të përfaqësuesve të ushtrisë dhe u mbajtën takime të rëndësishme me përfaqësues të lartë të komunitetit të atëhershëm ndërkombëtar. Zhvillimet e ofruara në dokument garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të të gjithë qytetarëve që jetojnë në të. Gjithëpërfshirja, zhvillimi i baraspeshuar dhe i qëndrueshëm, promovimi i transparencës së plotë në planifikim, janë disa nga parimet që dëshmojnë se dokumenti është në përputhje me standardet kryesore që dalin nga ligjet e vendit dhe rregulloret evropiane.



▷ Koncepti i zhvillimit hapësinor




## Plani Hapësinor i Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”

Është dokumenti kryesor hapësinor për sektorin energjetik, që siguron kornizën bazë në mbështetje të projekteve të ndryshme edhe nga sektorët tjerë qeveritar. Me këtë dokument Qeveria e Kosovës në mënyrë të qëndrueshme orienton kahen e zhvillimit hapësinor energjetik duke respektuar në maksimum mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimit racional të resurseve natyrore. Zhvillimi i ofruar ekonomik, nëpërmjet zhvillimit të sektorit energjetik, duke siguruar prodhim dhe furnizim të rregullt të energjisë elektrike, është garant edhe për zhvillim të barabartë social dhe mjedisor në të gjitha komunat pjesëmarrëse të zonës.

Duke qenë të vetëdijshëm për situatën e vështirë ekonomike dhe problemet e shumta që po ballafaqohet vendi ynë, jemi të sigurt që dokumenti i ofruar i zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës, është kontribut i rëndësishëm në konsolidimin e situatës energjetike në Kosovë. Prandaj, është shumë e rëndësishme të kuptohet se për realizimin e këtij Plani, do të duhet gjithsesi ndihma e të gjithëve, në mënyrë që bashkërisht të ndikojmë në zbutjen e problemit energjetik dhe në ndërtimin e mjedisit më kualitativ jetësorë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

▷ Harta kryesore e dokumentit




### LEGJENDA



### Plani Hapësinor për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushes”


Si përmbajtje është dokumenti kryesor i zhvillimit hapësinor të zonës, në të cilin me shumë kujdes janë trajtuar të gjitha çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave që ka zona në përgjithësi. Dokumenti është hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor nën përkrahjen e përfaqësuesve të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë dhe me kontributin shumë të çmueshëm të përfaqësuesve të komunave pjesëmarrëse në zonë. Në këtë drejtim, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë edhe profesionistë të fushës, përfaqësues të universiteteve, grupe të ndryshme të interesit duke përfshirë edhe kontributin e qytetarëve dhe shoqërisë civile.



Me kujdes të shtuar janë bërë hulumtimet e nevojshme për gjendjen ekzistuese të zonës, si rezultat i të cilës, në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit është vendosur për vizionin, si parakusht për të përfunduar fazën më të rëndësishme të procesit – Strategjinë e zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës. Zhvillimet e ofruara janë në harmoni të plotë me normat dhe standardet e lejuara dhe do të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës aktuale mjedisore.

Në mes tjerash, rëndësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit të turizmit dhe komponentëve që ndërlidhen me këtë fushë të rëndësishme ekonomike, nga e cila padyshim do të kemi përfitim të gjithë.

▷ Koncepti i zhvillimit hapësinor



### Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri"

Dokumenti në fjalë është rezultat bashkëpunimit me sektorët e rëndësishëm të Qeverisë, përmes Grupit Punues Ndërministror.


Përmbajtja e dokumentit ka të bëjë me mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës më të bukur natyrore të Kosovës, i cili përfundimisht do të ndikojë në rritjen e kontrollit të zhvillimeve dhe ndërprerjen e keqtrajtimit të vlerave të dëshmuara natyrore.

▷ Harta kryesore e dokumentit

### Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë "Beteja e Koshares"

Përmbajtja e dokumentit kryesisht ndërlidhet me ruajtjen dhe promovimin e vlerave të luftës, përmes të cilave do të mbetet e freskët sakrificat dhe lufta e popullit tonë për liri. Zhvillimi i ardhshëm hapësinor i zonës së Koshares fillon dhe mbaron në pikën qendrore - varrezat e dëshmorëve, që njëherit paraqesin përmbajtjen më të rëndësishme të të gjithë zonës. Aty qëndron themeli i të gjitha zhvillimeve dhe aty gërshetohen rrugët që e lidhin vet zonën me përmbajtjet dhe zhvillimet hapësinore përreth saj. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, Zona e Koshares me të gjitha përmbajtjet që shtrihen përreth saj, mund të shndërrohet në një atraksion turistik të qëndrueshëm, me ndikim në zhvillimin e të gjithë rajonit, duke i përfshirë edhe përmbajtjet që janë në anën tjetër të kufirit.

▷ Koncepti i zhvillimit hapësinor




## Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Është dokumenti kryesor i zhvillimit hapësinor të zonës, në të cilin me shumë kujdes janë trajtuar të gjitha çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave që ka zona në përgjithësi. Dokumenti është hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor nën përkrahjen e përfaqësuesve të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë dhe me kontributin shumë të çmueshëm të përfaqësuesve të komunave pjesëmarrëse në zonë. Në këtë drejtim, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë edhe profesionistë të fushës, përfaqësues të universiteteve, grupe të ndryshme të interesit duke përfshirë edhe kontributin e qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Me kujdes të shtuar janë bërë hulumtimet e nevojshme për gjendjen ekzistuese të zonës, si rezultat i të cilës, në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit është vendosur për vizionin, si parakusht për të përfunduar fazën më të rëndësishme të procesit – Strategjinë e zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës. Zhvillimet e ofruara janë në harmoni të plotë me normat dhe standardet e lejuara dhe do të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës aktuale mjedisore. Në mes tjerash, rëndësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit të turizmit dhe komponentëve që ndërlidhen me këtë fushë të rëndësishme ekonomike, nga e cila padyshim do të kemi përfitim të gjithë

▷ Harta e zonimit



### Plani Hapësinor PK Bjeshkët e Nemuna

#### Zonimi në Park

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Instituti për Planifikim Hapësinor

#### Legjenda:

- Kufiri i Kosovës
- Kufijtë Komunal
- Kufiri i Parkut
- ZVM
- Zona e Parë
- Zona e Parë - e propozuar
- Zona e Dytë
- Zona e Tretë




## **Dokumentet e pa aprovuara**

### **Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë “Hidrocentrali Zhur”**

Paralelisht me aktivitetet e lartpërmendura është punuar në përkufizimin e draftit të parë të Planit Hapësinor për, aktualisht hidrocentralin më të madh të Kosovës. Për shkak të ndikimit të tij edhe jashtë kufirit të vendit, momentalisht, procesi për përfundimin e dokumentit është stopuar, deri në krijimin e kushteve më të favorshme ekonomike dhe politike.

▷ Harta e zhvendosjes



### **Draft Harta Zonale e Kosovës**

Qëllimi kryesor i hartimit dhe i hyrjes në fuqi të Hartës Zonale të Kosovës është koordinimi i zhvillimeve hapësinore në të gjithë territorin e vendit. Përmes veprimeve, masave dhe aktiviteteve që janë njëra nga pjesët e rëndësishme të dokumentit, do të bëhet e mundur implementimi i politikave, qëllimeve dhe objektivave të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Në hartë janë të përcaktuara zonat për të cilat do të vendosen kushtet zhvillimore të obligueshme për të gjitha subjektet pjesëmarrëse në implementim. Me qëllim të ndërprerjes së dukurive negative që po ndodhin në hapësirë, Harta Zonale e Kosovës do të jetë instrumenti praktik, me të cilin do të bëhet më i lehtë zbatimi dhe monitorimi i veprimeve të planifikuara.



## Hulumtime dhe analiza të ndryshmet

### Vendbanimet joformale në Kosovë

Dokumenti në fjalë prezanton njërin ndër hulumtimet e para që është realizuar nga Instituti, Departamenti dhe njësitë tjera relevante duke përfshirë edhe studentët e Universitetit të Prishtinës të cilët e kanë realizuar me shumë sukses mbledhjen e të dhënave nga terreni.

Vendbanimet joformale janë definuar si vendbanime njerëzore, të cilat nuk u mundësojnë banorëve të vet t'i gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të jetesës, në veçanti banim adekuat. Si të tilla ato shquhen me karakteristikat si vijon: Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë; Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare; Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje; dhe Rrezikshmëria deri në diskriminim. Sipas përgjegjësive të kohës është përfunduar hulumtimi në fjalë duke ofruar një vlerësim mbi gjendjen e vendbanimeve joformale në Kosovë dhe banorëve të tyre, i cili është prezantuar para grupit të palëve të interesit. Të gjeturat e raportit kanë ndikuar në zvogëlimin e numrit dhe trajtimin adekuat të vendbanimeve të tilla, të cilat në disa raste në Kosovë janë prezantuar si shembuj suksesi.

### Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor

Përmes këtij studimi të ndërmarrë në bashkëpunim me CHëB-në, kemi provuar të përshkruajmë dhe analizojmë çështjen e trashëgimisë kulturore, dhe përfshirjen e saj në planet hapësinore të niveleve të ndryshme. Një vështrim të veçantë i kemi bërë atë kohë draft Planit Hapësinor të Kosovës dhe rekomandimeve që dalin nga ky dokument i rëndësishëm i zhvillimit hapësinor të Kosovës. Në mënyrë më specifike analiza dhe hulumtimi është realizuar në dokumentet përkatëse hapësinore për komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Gjakovë, Pejë dhe Hani Elezit, të cilat në aspektin e trashëgimisë kulturore përfaqësojnë komunat tipike të Kosovës. Pjesë e rëndësishme e këtij studimi jenë përfundimet dhe rekomandimet e fundit, që do të jenë ndihmë në përcaktimin e qartë të hapave të nevojshëm, për të kontribuar në trajtimin e drejtë të trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit hapësinor në Kosovë.

## VENDBANIMET JOFORMALE

### Hulumtim i gjendjes ekzistuese Raport



Tetor 2005

## PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANIFIKIM HAPËSINOR

### S T U D I M

#### Rastet e studimit:

Draft Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+

Planet përkatëse komunale:

- Komuna e Mitrovicës,
- Komuna e Vushtrrisë,
- Komuna e Gjakovës,
- Komuna e Pejës,
- Komuna e Hani Elezit

Iniciues – Trashëgimia Kulturore pa Kufi (CHwB)

Bartës i studimit – Instituti për Planifikim Hapësinor - MMPH

### Indikatorët për planifikim hapësinor

Ky dokument i hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor paraqet indikatorë për fushën e planifikimit hapësinor. Përmbajtja dhe rezultatet e indikatorëve janë të bazuar në të dhënat aktuale të sektorëve relevant të Qeverisë së Kosovës, dhe të dhënat nga burime të ndryshme kredibile për fushat përkatëse. Pjesa e konsiderueshme e analizave, grafikëve, tabelave, hartave dhe fotove të prezantuara në dokument janë origjinale, janë produkt i angazhimit të zyrtarëve përgjegjës për temat përkatëse. Dokumenti është i natyrës së hapur, i cili gjatë gjithë kohës do të plotësohet me informata dhe analiza të përditësuara për indikatorët e trajtuar. Të gjitha këto informata janë të publikuara në Ueb-faqen e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe do të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit, me fokus të veçantë në komunitetin e planerëve, duke përfshirë edhe përgjegjësit e të dy niveleve të planifikimit hapësinor në Kosovë.



### Zgjerimi i zonave urbane në Kosovë


Rritja apo zgjerimi urban po vazhdon edhe sot, por deri më tash asnjëherë nuk është matur niveli i kësaj rritjeje dhe nuk është përcaktuar trendi i zhvillimit të këtij fenomeni, me ndikim të madh në përcaktimin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor. Me qëllim të nxjerrjes në pah të disa informatave bazike për këtë çështje, Instituti për Planifikim Hapësinor përmes kapaciteteve të sajë ka zhvilluar një hulumtim, i cili ka dhënë disa informata preliminare shumë të nevojshme, si për nivelin qendrorë ashtu edhe për nivelin lokal.

Analiza ka pas për qëllim hulumtimin e rritjes urbane në tri etapa kohore, ashtu që të prodhohen rezultate që do të mund të krahasohen dhe të cilat do të mundësonin edhe nxjerrjen e trendit të rritjes apo zgjerimit urban të zonave urbane në Kosovë. Fillimisht janë hulumtuar zonat urbane të vitit 2001, ku përmes ortofotove është bërë vijëzimi dhe matja e të gjitha zonave urbane për këtë vit, pastaj parim i njëjtë është përdorur edhe për vitin 2012. Meqenëse atëkohë Kosova nuk ka pas ortofoto të vitit 2018, si burim alternativ kemi përdorur imazhet satelitore të ofruara nga Google Earth.




### **Harta e pronësisë për territorin e Kosovës**

Me iniciativën e Institutit për Planifikim Hapësinor dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi përfunduar draftin e parë të Hartës së Pronësisë për territorin e Kosovës. Harta e pronësisë është një dokument hartografik, i cili tregon shtrirjen gjeografike të tipeve të pronave dhe raportin në mes tyre. Pra, harta në fjalë tregon ku shtrihen pronat shtetërore, publike dhe private në territorin e Kosovës dhe cilat tipe pronësore janë në fjalë. Qëllimi i përfundimtar i kësaj iniciative është të punohet harta e pronësisë së Kosovës në nivel Nacional dhe në nivel lokal, duke ndjekur një metodologji që e bënë të qartë realizimin e hartës me të gjitha përmbajtjet e saj. Të dhënat gjeohapësinore të cilat janë përdorur për gjenerimin e hartës së pronësisë janë siguruar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK). AKK-ja ka ofruar bazën vektoriale të parcelave kadastrale dhe bazën alfa numerike ose tabelore për parcelat në fjalë, duke përfshirë edhe tipin e pronësisë. Baza vektoriale ka poseduar të gjitha atributet e nevojshme, duke filluar nga emri i komunës, zonës kadastrale dhe numri apo ID e parcelës kadastrale. Ndërsa në bazën tabelore është shënuar tipi i pronësisë në nivel të parcelës kadastrale.



### **Harta e mobilitetit të ngadalshëm**

Harta e Mobilitetit të ngadalshëm ofron një alternativë të qëndrueshme për të lëvizur në një destinacion atraktiv duke përfshirë ecje, ngasje dhe ngjitje. Harta përqendrohet në tri dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm: mjedisi, ekonomia dhe barazia sociale. Harta në fjalë, do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, rural, duke rritur prodhimtarinë bujqësore dhe duke krijuar vende të reja pune, të cilat do të ndikojnë në rritjen e ekonomisë lokale, përmes përfitimit të të ardhurave nga zhvillimi i bizneseve turistike për akomodim, restoranteve si dhe kultivimit të produkteve bujqësore lokale. Po ashtu, harta do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës, e cila do të ndihmojë në qasjen më të lehtë dhe të sigurt të lëvizjes së qytetarëve dhe të vizitorëve. Harta/Projekti ynë është një iniciativë e rëndësishme, që synon të ndryshojë jetën e njerëzve dhe të ndikojë pozitivisht në komunitetin tonë.





### **Trekëndëshi i zhvillimit ekonomik në Kosovë**

*Analiza hapësinore për Trekëndëshin e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (TZHEK) është një mundësi për të parë se cilat janë resurset dhe potencialet e mundshme në këtë zonë për zhvillimin e projekteve të ndryshme me karakter infrastrukturor dhe të tjera. TZHEK-u është hapësira gjeografike më vitale e Republikës së Kosovës për shkak të gërshetimit dhe mbivendosjes së shumë përmbajtjeve të karakterit strategjik në Kosovë. Aktualisht ky rajon është promotor i zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës me një përqendrim të lartë të aktiviteteve ekonomike dhe me potencialet e shumta që ka, të cilat presin fillimin e zhvillimeve me karakter strategjik rajonal, nacional dhe më gjerë. Qëllimi i kësaj analize hapësinore është që përmes një studimi preliminar të shpërfaqen karakteristikat gjeografike, socio-ekonomike dhe mjedisore që ka rajoni i TZHEK-ut dhe më pas të analizohen mundësitë e zhvillimit të projekteve të ndryshme multi-strategjike në këtë zonë.*





## **Dokumentet në proces**

### **Plani i ri Hapësinor i Kosovës**

*Në fund të Muajit Gusht 2022, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Vendimin për fillimin e procesit të hartimit të Planit të ri Hapësinor të Kosovës.*

*Hartimi i PH të Kosovës ka për qëllim krijimin e parakushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar në tërë territorin e Kosovës. Pjesë e rëndësishme e dokumentit të ri do të jenë rekomandimet nga Raporti i vlerësimit të zbatimit të Planit ekzistues, sipas të cilit, janë disa tema të rëndësishme që i mungojnë dokumentit si: Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë – që është njëri nga kapitujt kryesor në të cilin në detaje paraqiten aktivitetet, afatet kohore, kosto e përafërt dhe institucioni përgjegjës për zbatimin e tij; Lista e Indikatorëve matës – me anë të të cilëve duhet të bëhet vlerësimi i zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në dokument; Të dhënat e aktuale – në dokumentin ekzistues të dhënat janë të vjetruara dhe në disharmoni me gjendjen aktuale; Informatat për pronësinë (pronësi publike dhe private) – kjo informatë është e domosdoshme për një dokument të këtij niveli, e cila do të jetë vendimtare për të përcaktuar lokacionet adekuate për zhvillim; Strategjitë e sektorëve me ndikim në hapësira – gjatë hartimit të PHK-së në fuqi ka pasur mungesë të theksuar të strategjive sektoriale, të cilat kanë ndikuar që disa nga zhvillimet e rëndësishme sektoriale të mos jenë pjesë e dokumentit; dhe Zhvillimet aktuale në terren – do të kenë ndikim në përcaktimin e përmbajtjes përfundimtare të Planit të ri Hapësinor të Kosovës;*

### **Plani i ri Hapësinor për PK “Sharri”**

*Në fund të Muajit Gusht 2022, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Vendimin për fillimin e procesit të hartimit të Planit të ri Hapësinor për PK “Sharri”.*

*Arsyet për fillimin e procesit të hartimit të dokumentit të ri janë rekomandimet nga Raporti për vlerësimin e zbatimit të dokumentit ekzistues, në të cilin mungojnë temat si në vijim: Zonimi i përcaktuar në dokumentin ekzistues nuk është më adekuat. Për pasojë, kemi zhvillime që janë në kundërshtim me zhvillimet e planifikuara në zonat: I, II, dhe III; Përgjegjësia e pa definuar në mes të nivelit lokal dhe qendrorë, i cila ka ndikuar direkt në zhvillimet e pakontrolluara në Park; Në dokumentin ekzistues është evidentuar mungesa e Indikatorëve matës, me anë të të cilëve duhet të bëhet vlerësimi i zbatimit të qëllimeve dhe objektivave, të përcaktuara në dokument; Njëri nga problemet esenciale në procesin e hartimit të dokumentit në fuqi ka qenë mungesa e informatave për pronësinë në kuadër të territorit të Parkut. Nuk ka qenë e mundur të definohen qartë zonat në pronësi publike dhe private;*





## **Bashkëpunimi**

*Karakteristikë e punës së deritashme të Institutit ka qenë bashkëpunimi dhe ndihma reciproke me të gjithë pjesëmarrësit në proces. Bashkëpunimi është i të gjitha niveleve, duke filluar nga organet më të larta qeveritare, ato komunale e deri te organizatat e huaja dhe vendore, profesionistë dhe individë të pavarur, me të cilët ky bashkëpunim është plotësuar edhe me diskutime të shpeshta publike.*

*Ndihmë e konsiderueshme në këto aktivitetet është dhënë nga ana e UN-Habitat-it përmes IHS-it – Institutit për Banim dhe Studime të Zhvillimit Urban - Holandë, e cila ndihmë më së shumti konsistoi në ngritjen kapaciteteve profesionale. Një bashkëpunim i veçantë ka qenë me projektin ALUP (Agriculture land Utilitasion Project), i cili ka ndikuar në ngritjen reciproke të kapaciteteve rreth menaxhimit dhe planifikimit rural. Në mënyrë të ngjashme kemi bashkëpunuar edhe me UNDP, SIDA, CHwB, AGRIFOR, me theks të veçantë në gjetjen e mundësive për ngritjen dhe zhvillimin institucional në fushën e planifikimit hapësinor.*

*Gjatë kësaj periudhe ndër bashkëpunimet e rëndësishme ka qenë edhe puna deri më tash joformale, me studentë të fushave të ndryshme. Kemi arritur që për një numër të konsiderueshëm të studentëve të ofrojmë hapësirë dhe informata të mjaftueshme për kryerjen e pjesës praktike të studimeve universitare.*

## **Pajisja teknike dhe baza e shënimeve**

*Pajisja teknike që disponon Instituti është e nivelit të konsiderueshëm dhe me plotësimin e adekuat të nevojshëm mund ti përgjigjet kërkesave të kohës. Në kuadër të Institutit vepron sektori profesional i GIS-it, në kuadër të të cilit punojnë tashmë profesionistë të përgatitur dhe të gatshëm që të krijojnë të dhëna dhe analiza të nevojshme. Realizimi i projekteve të deritashme ka ndikuar në krijimin e një baze të mirë të shënimeve, të nevojshme për paraqitjen sa më reale të zhvillimeve hapësinore në të gjithë territorin e Kosovës.*





## Stafi



**Luan NUSHI** (1960), arkitekt<sup>3</sup> planer - **Drejtor, Magjistër** i shkencave në studime profesionale në Universitetin Amerikan të Kosovës, në partneritet me Rochester Institute of Technology (SHBA), me temë “Përmirësimi i sistemit të planifikimit hapësinor në Kosovë”. Angazhimet e para profesionale të tij lidhen me fushën e ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore, ku për disa vite, ka ushtruar detyrën e dizajnerit dhe udhëheqësit të punimeve. Në fushën e planifikimit hapësinor është aktivizuar në vitin 2002, në cilësinë e drejtorit të Departamentit të Planifikimit Hapësinor në MMPH. Në vazhdimësi ka ndjekur dhe përfunduar një sërë aftësimesh profesionale në këtë fushë. Prej vitit 2006 është drejtor në Institutin për Planifikim Hapësinor, nën udhëheqjen e të cilit në bazë të mandatit, janë hartuar një numër i konsiderueshëm i dokumenteve të planifikimit hapësinor. Përpos angazhimeve menaxheriale, kontributi i tij është i përgjithshëm duke përfshirë shumicën e temave që trajtohen në kuadër të fushëveprimit të Institutit. Një angazhim të veçantë ka treguar gjatë procesit të përgatitjes së legjislacionit dhe udhëzimeve përcjellëse në fushën e planifikimit hapësinor. Nën koordinimin e tij me sukses janë iniciuar dhe realizuar një sërë bashkëpunimesh të Institutit me institucione dhe programe të ndryshme duke përfshirë: kontributin e dhënë në projekte të ndryshme ndërmministrorë; ndihmën profesionale gjatë procesit të hartimit të planeve hapësinore në shumë komuna të Kosovës; bashkëpunimin me Universitetin; dhe përfundimin e suksesshëm të bashkëpunimit me shumë projekte dhe programe relevante ndërkombëtare të zhvilluara në Kosovë.



**Faton DEVA** (1959), arkitekt planer - **Udhëheqës i Divizionit për Planifikim dhe Bashkëpunim, Magjistër** për “Planifikim Hapësinor Evropian dhe Zhvillim Regjional” në Universitetin Teknologjik të Blekinges, në Karlskrona të Suedisë. Që nga viti 2003 është pjesë e stafit të Institutit për Planifikim Hapësinor, gjatë të cilës periudhë në mes tjerash është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë), Planifikim të Integruar Urban (BTH, Suedi), Agri-green Management (në weitz Center for development Studies, Izrael) . Gjatë punës në IPH ka qenë pjesëmarrës aktiv në hartim të shumë analizave komunale dhe planeve hapësinore me ekspertizë në fushën tematike “Mjedisi dhe Shfrytëzimi i tokës”. Kryesisht mbulon fushat tematike që ndërlidhen me bujqësinë, mjedisin dhe të trashëgiminë natyrore e kulturore në “Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020” dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta me interes për vendin, si: “Fusha e Mihjes së re”, “Kleçka dhe Divjaka”, Parku kombëtar “Sharri”, “Hydrocentrali i Zhurit”, “Beteja e Koshares”, “Ujëvarat e Mirushes”, Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, pastaj në draft “Harta Zonale e Kosovës” si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, etj. Gjithashtu, mori pjesë në hartim dhe shqyrtim të shumë dokumenteve strategjike, politikave zhvillimore dhe legjislacionit mbështetës për planifikim dhe zhvillim hapësinor.



**Zana MEHMETI** (1967), arkitekte planere - **Zyrtare e Lartë për Planifikim**, Që nga viti 2003, është pjesë e IPH-së, gjatë të cilës periudhë në mes tjerash është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë). Pjesëmarrëse në hartim të planeve hapësinore me ekspertizë në fushën e zhvillimit ekonomik, duke përfshirë çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të turizmit si: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 dhe Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta me interes për vendin: Parku Kombëtar “Sharri”, “Hydrocentrali i Zhurit”, “Kleçkë dhe Divjakë”, “Fusha e Mihjes së re”, “Ujëvarat e Mirushes”, “Beteja e Koshares” dhe Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, pastaj në draft “Harta Zonale e Kosovës” si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, etj. Përgatitjen e strategjive dhe politikave zhvillimore hapësinore dhe punë kërkimore për planifikim dhe zhvillime hapësinore.

<sup>3</sup> Arkitekt/e - Inxhinier i diplomuar i arkitekturës / Grada fitohet pas 5 vitesh, gjegjësisht 10 semestrash të studimeve dhe është e barasvlefshme me 300 ECTS/(www.uni-pr.edu).



**Shpend AGAJ** (1966), gjeograf planer - **Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim** - master në drejtimin Menaxhimi i Emergjencave në Kolegjin e Biznesit, Prishtinë. Gjithsejtë, 12 vite pune në arsim si profesor i gjeografisë dhe që nga viti 2003 është pjesë e stafit të IPH, gjatë të cilës periudhë në mes tjerash është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë). Pjesëmarrës në hartim të shumë planeve hapësinore me ekspertizë në fushën tematike të mjedisit dhe shfrytëzimit të tokës si: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 dhe Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta të Kosovës: Parku Kombëtar "Sharri", "Hidrocentrali i Zhurit", "Kleçkë dhe Divjakë", "Fusha e Mihjes së Re", "Ujëvarat e Mirushes", "Beteja e Koshares" dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", pastaj në draft "Harta Zonale e Kosovës" si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri". Pjesëmarrës aktiv në hartimin e dokumenteve komunale si analizat hapësinore për: Vushtrri, Kamenicë, Kaçanik, Suharekë, Dragash, Malishevë, Obiliq, etj. Gjithashtu, pjesëmarrës në hartim dhe shqyrtim të shumë politikave zhvillimore hapësinore dhe dokumenteve strategjike, legjislatonit të duhur mbështetës për planifikim dhe zhvillim hapësinor.



**Arbën RRECAJ** (1961), arkitekt planer - **Udhëheqës i Divizionit për Hulumtim dhe Vlerësim** - magjistër i shkencave në studime profesionale në Universitetin Amerikan në Kosovë, në partneritet me Rochester Institute of Technology (SHBA). Në Institutin për Planifikim Hapësinor është i punësuar që nga viti 2003, gjatë të cilës periudhë në mes tjerash është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë). Pjesëmarrës aktiv në kryerjen e analizave hapësinore për disa komuna të Kosovës dhe në hartimin e planeve hapësinore me ekspertizë në fushën tematike "Infrastruktura fizike" e cila përfshinë: infrastrukturën e transportit, infrastrukturën e energjetikës, infrastrukturën ujore, telekomunikacionin dhe menaxhimin e mbeturinave. Ka punuar në hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020 dhe Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta si: Parku Kombëtar "Sharri", "Fusha e Mihjes së Re", "Kleçka dhe Divjaka", "Hidrocentrali i Zhurit", "Ujëvarat e Mirushës", "Beteja e Koshares" dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", pastaj në draft "Harta Zonale e Kosovës", si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri", etj. Gjithashtu pjesëmarrës në hartimin e dokumenteve strategjike dhe legjislatonit të nevojshëm mbështetës për planifikimin hapësinor.



**Gëzime GRAJQEVCI** (1971), arkitekte planere - **Zyrtare e Lartë për Hulumtim**. Në Institutin për Planifikim Hapësinor është e punësuar që nga viti 2009. Gjatë kësaj periudhe është trajnuar në fushën e Menaxhimit të mjedisit lokal për zonat urbane, Suedi 2010/2011. Pjesëmarrëse në hartimin e planeve hapësinore duke mbuluar çështjet që ndërlidhen me fushën tematike të banimit, ndërtimit dhe planifikimit në dokumentet si: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 si dhe në Planet Hapësinore për Zona të Veçanta: "Fusha e Mihjes së Re", "Kleçkë e Divjakë", "Hidrocentrali i Zhurit", "Ujëvarat e Mirushës", "Beteja e Koshares" dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", pastaj në draft "Harta Zonale e Kosovës" si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri". Po ashtu ka ofruar ndihmesë profesionale nivelit komunal në hartimin e disa planeve zhvillimore komunale. Është pjesë e Akademisë Evropiane të Mjedisit për përafrimin e legjislatonit dhe integritit të acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit.



**Atdhe DESKU** (1981), arkitekt planer - **Zyrtar i Lartë për Vlerësim** - kandidat për master për "Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor" në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, Prishtinë. Që nga viti 2017 është pjesë e Institutit për Planifikim Hapësinor. Gjatë kësaj periudhe pune në IPH ka dhënë kontribut në analizimin dhe vlerësimin e Planeve Zhvillimore Komunale të disa Komunave të Kosovës, ka marrë pjesë aktive në hartimin e dokumentit "Indikatorët për Planifikim Hapësinor në Kosovë". Kryesisht mbulon fushat tematike që ndërlidhen me arsimin dhe shëndetësinë në kuadër të procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor qendror në: "Hartën Zonale të Kosovës", Planin e ri Hapësinor të Kosovës dhe Planin e ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri". Gjithashtu ka marrë pjesë në shqyrtim dhe komentimin e dokumenteve dhe legjislatonit për planifikim hapësinor dhe arkitekturë.



**Rizah MURSELI** (1979), gjeograf planer - **Udhëheqës i Divizionit për GIS** - Magjistër i shkencave në drejtimin Modelet Hapësinore Socio-Ekonomike të përfunduar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. I angazhuar në Institutin për Planifikim Hapësinor që nga viti 2003, gjatë të cilës periudhë në mes tjerash është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë), Planifikim të Integruar Urban (BTH, Suedi), pjesëmarrës në Shkollën Verore të Planerëve të Rinj (Wroclaw, Poloni) dhe është përfaqësues i Kosovës në rrjetin EIONET për Shfrytëzim Toke dhe Planifikim Hapësinor pranë Agjencisë Evropiane të Mjedisit. Në cilësinë e udhëheqësit në sektorin e GIS-it, ka marrë pjesë aktive në hartimin e projekteve dhe strategjive nacionale dhe lokale me karakter të zhvillimeve hapësinore, duke trajtuar fushat tematike të GIS-it dhe shfrytëzimit të tokës dhe duke aplikuar metodologji bashkëkohore në krijimin e hartave dhe trajtimit të shfrytëzimit /mbulueshmërisë së tokës në shkallë të ndryshme hapësinore regjionale dhe urbane në dokumentet: "Plani Hapësinor i Kosovës 2010- 2020" dhe në Planet Hapësinore për Zona të Veçanta me interes për vendin: Parku Kombëtar "Sharri", "Fusha e Mijhes së Re", "Kleçkë e Divjakë", "Hidrocentrali i Zhurit", "Ujëvarat e Mirushës", "Beteja e Koshares" dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", pastaj në draft "Harta Zonale e Kosovës" si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri".



**Festa NIXHA-NELA** (1968), arkitekte planere - **Zyrtare e Lartë për Analiza Hapësinore** - Prej vitit 2003 e angazhuar në Institutin për Planifikim Hapësinor, gjatë të cilës periudhë është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë) dhe nën përkrahjen e donatorëve ka avancuar kapacitetin edhe me njohuri në fushën e trajtimit të duhur të trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor dhe shfrytëzimin e GIS dhe CAD platformës për përgatitjen e hartave. Pjesëmarrëse aktive në hartimin e planeve hapësinore si: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 dhe Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta: Parku Kombëtar "Sharri"; "Fusha e Mijhes së Re"; "Kleçkë e Divjakë"; "Hidrocentrali i Zhurit"; "Ujëvarat e Mirushës", "Beteja e Koshares" dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", pastaj në draft "Harta Zonale e Kosovës" si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri". Një angazhim të veçantë ka treguar në përkrahjen e stafit lokal në përgatitjen e planeve përkatëse komunale.



**Mimoza KALLABA** (1977), gjeografe planere - **Zyrtare e Lartë për Bazën e të Dhënave** - Magjistër e shkencave në drejtimin Modelet Hapësinore Socio-Ekonomike të përfunduar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. E angazhuar në Institutin për Planifikim Hapësinor prej vitit 2003, gjatë të cilës periudhë është trajnuar për planifikim dhe menaxhim urban (nga IHS, Holandë). Pjesëmarrëse në hartim të shumë planeve hapësinore: Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020 dhe Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta si: Parku Kombëtar "Sharri", "Fusha e Mijhes së Re", "Hidrocentrali i Zhurit", "Kleçkë e Divjakë", "Ujëvarat e Mirushës", "Beteja e Koshares" dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", pastaj në draft "Harta Zonale e Kosovës" si dhe në planet hapësinore që janë në proces: Plani i ri Hapësinor i Kosovës dhe Plani i ri Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri". Pjesëmarrëse në hartimin e shumë analizave hapësinore komunale: Vushtrri, Kamenicë, Kaçanik, Suharekë, Dragash, Malishevë, etj.



**Aylin Yağcılar Şilik** (1990), planere urbane - **Zyrtare e Lartë për Analiza Hapësinore** - Magjistër në drejtimin "Konservimi dhe Rigjenerimi Urban" në Mimar Sinan Güzel Sanatlar Üniveristesi, në Stamboll. Në vitin 2014, nga Programi e Erasmus është përgjegjdhur për të vazhduar studimet për master për Studime Urbane dhe Menaxhim të Territorit në Instituto Superior Técnico Lisboa në Portugali. Ka filluar punën në Institutin për Planifikim Hapësinor më 2019. Gjatë kësaj periudhe ka dhënë kontribut në analizën dhe hartimin e hartave të ndryshme në IPH, ka marrë pjesë aktive në hartimin e dokumentit "Analiza e Zhvillimit Hapësinor Liqeni i Batllavës", në koordinimin e projektit për "Mobilitetin e ngadalshëm" dhe përgjegjëse për hartimin e hartave në Planin e ri Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri". Kryesisht mbulon fushat tematike që ndërliken me turizmin, dizajnin urban dhe konservimin urban në kuadër të procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në IPH.



## Vizioni

*“Qendër profesionale dhe arsimore për hulumtime dhe publikime në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, të shfrytëzimit racional të hapësirës, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të projekteve. Qendër e promovimit të vlerave të planifikimit gjithëpërfshirës, e promovimit të proceseve demokratike dhe qendër e respektimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare në fushën e planifikimit hapësinor dhe menaxhimit urban. Instituti duhet të shndërrohet në qendër referente për mbledhjen, analizën dhe ofrimin e të dhënave hapësinore për Kosovën, institucion i hapur dhe konkurrent me institucionet e ngjashme në rajon dhe më gjerë, e gatshme për të ofruar shërbime hulumtimi brenda dhe jashtë vendit.”*

## Objektivi

*Objektivi kryesor i Institutit për Planifikim Hapësinor është – ngritja e institucionit në nivel në të cilin do të jetë i gatshëm, në njërin anë të ofrojë shërbime për Qeverinë e Kosovës dhe në anën tjetër, nga angazhimet profesionale, të krijoj të hyra të mjaftueshme për zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve të veta. Në bashkëpunim me MASHT-in dhe Universitetin e Prishtinës të gjendet forma e duhur për bashkëpunim të qëndrueshëm, nga i cili do të përfitojnë më së shumti studentët, për të cilët IPH momentalisht është e vetmja adresë e mësimin të përvojave në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban.*

## Si të arrihet?

**Kualiteti** – Instituti ka për qëllim të ngritë kualitetin e punës që konsiston në hulumtimet për zhvillimet hapësinore urbane e rurale në Kosovë dhe më gjerë, përpilimin e planeve hapësinore, koordinimin e zhvillimit hapësinor në Kosovë dhe zhvillimeve ndërkufitare me vende fqinje. Ngritja e kualitetit do të bëhet me ngritjen e vazhdueshme profesionale të punëtorëve të IPH-së, ngritjen e vazhdueshme institucionale, me masa për përmirësime të vazhdueshme sikur se janë: motivimi dhe stimulimi i punëtorëve, krijimi i kushteve të mira të punës e deri tek krijimi i mundësive për shkollim pas Universitar brenda dhe jashtë Kosovës.

**Konkurrenca** – Instituti i Planifikimit Hapësinor do të konkurrojë me institucionet tjera në Kosovë dhe jashtë saj me aktivitete hulumtuese, shkencore, planifikuese, këshilluese dhe shërbyese. Një angazhim i tillë është garanci për kualitet, dinamikë dhe efikasitet më të lartë. Duhet të ofrohen kushte dhe hapësirë e mjaftueshme në treg, për konkurrencë në të cilat Instituti në mënyrë të barabartë do të konkurrojë dhe të marrë shërbimet e nevojshme. Zgjerimi i portfolios së IPH-së me spektër më të gjerë projektsh dhe hulumtimesh, përtej obligimeve direkte ndaj qeverisë, do t'i ofronte Institutit mundësinë që të mbajë dhe sipas nevojës angazhojë ekspertët e kualifikuar. Në këtë mënyrë Instituti do të jetë në gjendje ti rrisë kapacitetet e veta dhe me lehtësi ti përgjigjet kërkesave të tregut.

**Financimi** – Pas ristrukturimit të IPH-së janë përafëruar kushtet që një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të krijohet nga puna dhe shërbimet që mund të ofrojmë. Kjo do të realizohet pasi të vendosim rregullat të cilat në mënyrë të detajuar do të përcaktojnë përgjegjësitë e palëve duke përfshirë edhe përgjegjësinë e Institutit si palë shërbyese dhe palë në nevojë.

**Prioriteti** – ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e planifikimit hapësinor dhe menaxhimit urban në mënyrë që kjo fushë e



rëndësishme të bëhet pjesë e prioritetit për qeverinë qendrore dhe lokale. Vendimmarrësit në Kosovë duhet të kuptojnë se zhvillimet ndodhin për shkak të mos-planifikimit ose të planifikimit jo të mirë në hapësirë.

**Bashkëpunimi ndër-institucional** - Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi në nivelin horizontal dhe në atë vertikal, të bëhet në baza të rregullta. Duhet të shtohen përpjekjet nga të gjitha palët që kjo të funksionojë, në mënyrë që dokumentet e hartuara në Institut të kenë ndikim edhe të sektorëve tjerë.

**Edukimi** - Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale në Institut por edhe në institucionet lokale që merren me hapësirën, planifikimin, zhvillimin e saj, është parakusht për ngritjen e kualitetit të Planifikimit Hapësinor dhe urban në Kosovë. Aktualisht është e hapur, çdo kush mund të merret me planifikim hapësinor dhe urban - aktualisht nuk ka ndonjë kriter të përcaktuar. Është e nevojshme që kjo të vihet nën kontroll duke i përcaktuar kushtet, në mesin e të cilave duhet të përfshihet edhe shkalla e edukimit përkatës! Për këtë arsye, duhet të shtohen përpjekjet nga të gjithë përgjegjës, që të instalohet niveli Master i studimeve në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban. Rekomandohet që, për qëllim të plotësimit të kapaciteteve të munguara, gjenerata e parë e studentëve të përbëhet nga shërbyes civil të të dy niveleve të angazhuar në institucionet përkatëse të planifikimit dhe menaxhimit urban.

**Baza e shënimeve hapësinore** – Të vazhdohet me ndërtimin dhe strukturimin e bazës së shënimeve hapësinore, duke ngritur kapacitetet humane dhe teknike të sektorit të GIS-it në përgjithësi. Në këtë drejtim theks të veçantë duhet ti epet përcaktimit të rregullave ligjore, përforcimit të sektorit qendror të GIS-it në Institut dhe themelimit të njësive komunale të GIS-it. Një veprim i tillë do të ndikojë në harmonizimin e sektorit, duke përfshirë mënyrën e ndërtimit, prezantimit dhe ruajtjes së të dhënave hapësinore.

**Përgatitja për BE** - Ndër sfidat e kohës është përgatitja e stafit me njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në hartimin e projekteve për fondet e Bashkimit Evropian. Projektet kryesisht kanë të bëjnë me hapësirën, me zhvillimin ekonomik dhe fusha tjera tematike që kanë ndikim në hapësirë. Ky është argumenti kryesor që sektori, e në veçanti Instituti për Planifikim Hapësinor, duhet ta ketë parasysh gjatë fazës së integritimit të vendit në Bashkimin Evropian. Duhet të fillohen përgatitjet për përfshirjen e stafit në trajnimin dhe edukimin e nevojshëm, në mënyrë që të jemi të gatshëm për marrjen e përgjegjësi në propozimin, hartimin dhe udhëheqjen e projekteve të financuara nga fondet evropiane.



## **Në fund**

*Në njëzet vjetorin e punës dhe aktiviteteve të Institutit për Planifikim Hapësinor dhe të sektorit në përgjithësi, edhe përkundër rezultateve të përmendura më sipër, jemi të vetëdijshëm për problemet dhe mangësitë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban. Ka ende mungesë të kapaciteteve të nevojshme humane dhe teknike në të dy nivelet e qeverisjes. Situata në terren është e ndërlikuar në disa raste edhe kaotike, në të cilën është shumë e vështirë të ndikohet. Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimeve në hapësirë, nuk janë në përputhje me rekomandimet e dokumenteve që nxirren nga vet sektori. Për shkak të zbrazëtirave aktuale ligjore, mbikëqyrja dhe implementimi, si njëra ndër fazat më të rëndësishme të procesit të planifikimit hapësinor, ende nuk janë në nivelin e duhur.*

*Duke i pasur këto parasysh, mendojmë se është momenti i fundit që bashkërisht të vendosim dhe të veprojme në ndryshimin e kësaj situatë. Përgjegjësia na takon të gjithëve, duke filluar nga institucionet qendrore të cilat duhet të insistojnë në përforcimin e infrastrukturës ligjore dhe përcaktimin e qartë të pozicionit të të gjitha institucioneve përgjegjëse. Një përgjegjësi e madhe na takon edhe profesionistëve që me vetëdije ose pa të, shkelim rregullat e ndërtimit në emër të interesit material. Përgjegjës janë edhe qytetarët, një pjesë e të cilëve të ndodhur në situatë të vështirë ekonomike në njërën anë, dhe në anën tjetër para presionit të ndërmarrësve, me lehtësi po heqin dorë nga respektimi i ligjeve dhe rregullave në fuqi. Këtë situatë, edhe pse nuk është e lehtë mund ta ndryshojmë! - duhet të kemi më shumë kurajë, duhet të ndikojmë në raport me përgjegjësitë, duhet të fillojmë të ndërtojmë ndjenjën për “të përbashkëtën”, dhe çka është më e rëndësishmja - duhet tu japim më shumë hapësirë profesionistëve.*





## Instituti për Planifikim Hapësinor

Adresa:

Objekti i Qeverisë së Kosovës (Ish Rilindja)

Kati XIV, zyra 1405

[www.mmphi-rks.org](http://www.mmphi-rks.org)

<https://mmphi.rks-gov.net/Others/Department?DepartmentID=2>

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. +383 38 200 32552

## Monografi



*Përgatitur nga:*

*Instituti për Planifikim Hapësinor*

*Tetor, 2023*

